

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Auditim
(me zgjidhje)

P6

Data 18/07/2020

Detyra 1

- a) Duke iu referuar SNA / ISA 520 *Procedurat Analitike* shpjegoni:
- Çfarë nënkuptohet me termin 'Procedurat analitike'; **(2 pikë)**
 - Llojet e ndryshme të procedurave analitike që ka në dispozicion auditori; dhe **(3 pikë)**
 - Situatat që mund të dalin në pah gjatë auditimit dhe në të cilat mund të përdoren procedurat analitike. **(3 pikë)**

Joni Shpk shet pajisje ndriçimi dhe mobilie për kopshte me anë të 15 dyqaneve të shitjeve me pakicë. Shitjet i bëhen individëve, ndërsa të hyrat prej tyre gjenerohen në formën e parasë së gatshme ose me anë të kartave të debitit/kreditit. Të gjithë artikujt e blerë i shpërndahen klientëve duke përdorur automjetet e vetë Joni pasi që shumica e pajisjeve të ndriçimit janë shumë të mëdha për t'u transportuar nga individët me automjetet e tyre. Drejtorët e Joni tregojnë se kompania ka pasur një vit të vështirë, por megjithatë janë të kënaqur sepse janë të aftë të paraqesin disa rezultate të pranueshme ndaj anëtarëve të bordit të drejtorëve. Pasqyrat e të ardhurave për dy vitet e fundit financiare janë treguar më poshtë:

Pasqyra e të ardhurave

	31 dhjetor 2019 '000 Euro	31 dhjetor 2018 '000 Euro
Të hyrat nga shitja	7,482	6,364
Kosto e shitjeve	(3,520)	(4,253)
Fitimi bruto	3,962	2,111
Shpenzimet operacionale		
Administrata	(1,235)	(1,320)
Shitja dhe shpërndarja	(981)	(689)
Interesi	(101)	(105)
Të ardhura nga interesi	145	-
Fitimi (humbja) para tatimit	1,790	(3)

Ekstrakt nga pasqyra e pozicionit financiar

	31 mars 2019 '000 Euro	31 mars 2018 '000 Euro
Paraja e gatshme dhe banka	253	(950)

Kërkohe:

(b) Si pjesë e procedurave tuaja për vlerësimin e rrezikut për Joni Shpk, identifikoni dhe ofroni një shpjegim të mundshëm për ndryshimet e zakonshme në pasqyrën e të ardhurave (analizoni lëvizjet dhe ndryshimet në zëra). **(9 pikë)**

(c) Konfirmimi i tepricave të llogarisë së bankës në fund të vitit është një procedurë e rëndësishme auditimi.

Kërkohe:

(i) Shpjegoni procedurat e nevojshme për të përfutur një letër konfirmimi bankar nga banka e Joni Shpk. **(3 pikë)**

[Totali: 20 pikë]

Zgjidhje

(a)

(i) Shpjegimi i procedurave analitike: Procedurat analitike janë analizat e koeficienteve dhe të tendencave (prirjeve) më të rëndësishme të një entiteti, përfshirë këtu verifikimin e ndryshimeve dhe të koherencës me informacionet e tjera, të krahasuara këto me informacionin përkatës, ose që paraqesin shmangie të madhe nga shumat e parashikuara. Auditori duhet të zbatojë procedurat analitike si procedura të vlerësimit të rrezikut për të siguruar njohjen e entitetit dhe mjedisit në të cilin vepron ai dhe për të bërë një rishikim të përgjithshëm në fund të auditimit'. Përveç përdorimit të procedurave analitike të përmendura më sipër, në të njëjtën kohë, auditorët mund të përdorin edhe procedurat e pavarura, për të përfutur evidenca të drejtpërdrejta të auditimit. 'Procedurat analitike' aktualisht do të thotë vlerësimi i informacioneve financiare dhe informacioneve të tjera, dhe rishikimi i marrëdhënieve të parashikueshme midis këtyre informacioneve. Rishikimi në të njëjtën kohë përfshin identifikimin e luhatjeve dhe marrëdhënieve të cilat nuk duken në konsistencë me informacionet ose rezultatet e tjera përkatëse.

(ii) Llojet e procedurave analitike: Procedurat analitike mund të përdoren si:

- Krahasimi i informacioneve të krahasueshme me ato të periudhave të mëparshme për të identifikuar ndryshimet e pazakonshme ose luhatjet e pazakonshme në vlerat monetare.
- Krahasimi i rezultateve aktuale ose të pritshme të entitetit me buxhetet dhe/ose parashikimet, ose me rezultatet që presin vetë auditorët në mënyrë që të përcaktohet saktësia potenciale e rezultateve në fjalë.
- Krahasimi me informacionet e industrisë ose për të gjithë industrinë si një e tërë ose duke bërë krahasimin me entitete të madhësisë së ngjashme me klientin për të përcaktuar faktin nëse ditët e pagimit të llogarive të arkëtueshme, për shembull, janë të arsyeshme.

(i) Përdorimi i procedurave analitike:

- Procedurat e vlerësimit të rrezikut. Procedurat analitike në fillim të auditimit si procedura të vlerësimit të rrezikut për të siguruar njohjen e entitetit dhe mjedisit në të cilin vepron dhe për të vlerësuar rrezikun e anomalive materiale. Procedurat e auditimit me pas mund të fokusohen mbi këto zona 'të rrezikshme'.

- Procedurat analitike si procedura të pavarura: Procedurat analitike mund të përdoren si procedura të pavarura në për të përcaktuar rrezikun e anomalive materiale në nivel pohimesh gjatë punës që kryhet mbi pasqyrën e të ardhurave dhe pasqyrën e pozicionit financiar (bilancin e gjendjes).

- Procedurat analitike në fazën e rishikimit të përgjithshëm: Në këtë fazë i ndihmojnë auditorit që në fund të auditimit të formulojë një konkluzion të përgjithshëm për sa i takon faktit nëse pasqyrat financiare si një e tërë janë në përputhje me mënyrën se si auditori e ka kuptuar entitetin.

(b) Fitimi neto në përgjithësi: Rezultatet e Joni kanë ndryshuar nga një humbje net në një fitim neto. Duke pasur parasysh se shitjet janë rritur vetëm me 17 % dhe se shpenzimet, të paktën shpenzimet e administratës, duken të ulëta, ka shumë mundësi që shpenzimet të jenë të nënvlerësuara.

Shitjet - rriten me 17 %

Sipas drejtorëve, Joni ka pasur një 'vit të vështirë'. Arsyet për rritjen e të hyrave nga shitjet duhet të provohen meqenëse ndryshimi në to nuk është në përputhje me komentet e drejtorëve. Është e mundur që industria si një e tërë, të ketë pësuar rritje duke i lejuar Joni të përftojë kaq rezultate të mira.

Kostoja e shitjeve - ka rënë me 17 %

Rënia në koston e shitjeve është e pazakonshme duke pasur parasysh se shitjet janë rritur ndjeshëm. Një gjë e tillë mund të shkaktohet si rrjedhojë e vlerësimit të pa - saktë të stoqeve dhe përdorimit të furnitorëve të ndryshëm (më të lirë) gjë që mund të shkaktojë probleme me mallra defektoze gjatë vitit të ardhshëm.

Fitimi bruto (FB) - rritje me 88 %

Kjo është një rritje domethënëse në përqindjen e fitimit bruto sepse ka ndryshuar nga 33 % vitin e kaluar në 53 % në këtë vit. Gjatë identifikimit të arsyeve për këtë ndryshim do të duhet të fokusohet kryesisht mbi ndryshimet në shitje dhe koston e shitjeve.

Administrata - rënie me 6 %

Kjo rënie është e pazakonshme duke pasur parasysh se shitjet janë rritur dhe po kështu pritet të ketë një rritje në administratë për të mbështetur këto shitje.

Shpenzimet mund të jenë të nënvlerësuara, ose mund të ketë pasur një rënie në numrin e personelit të administratës.

Shitja dhe shpërndarja - rritje me 42 %

Kjo rritje nuk duhet të është në përputhje me rritjen në shitje - shitja dhe shpërndarja pritet zakonisht të pësojnë ndryshime në të njëjtin kah me shitjet. Shpenzimet mund të jenë shpërndarë keq nga administrata ose vjetërsia e kamionëve të Joni është rritur gjë që rezulton në kosto shtesë të shërbimit.

Interesi i pagueshëm - rënie e lehtë

Duke pasur parasysh se Joni ka një suficit [tepricë] të konsiderueshme të parasë së gatshme për këtë vit, fakti që vazhdon të paguajë interes është i çuditshëm. Shuma mund të jetë e mbi - vlerësuar - arsyet për mungesën e rënies në pagesat e interesit p. sh. kreditë që nuk mund të paguhën më herët, duhet të përcaktohen.

Të ardhurat nga investimet - të reja këtë vit

Një gjë e tillë pritet duke pasur parasysh suficitet [tepricat] e parasë së gatshme gjatë vitit, megjithëse shuma monetare është ende e lartë, gjë që tregon gabime të mundshme në shumën monetare ose pasuritë e tjera që gjenerojnë të ardhura dhe që nuk janë shpjeguar në fragmentin e bilancit të gjendjes.

(c) Përfitimi i konfirmimit bankar

- Rishikoni nevojën për të përftuar një letër nga banka nga informacionet e përfthuara nga vlerësimi fillestar i rrezikut të Joni.
- Përgatitni një letër standarde të bankës në formatin e dakorduar me bankat në juridiksionin tuaj.
- Përftoni autorizimin e njërit nga drejtorët e Joni që banka t'i japë informacione të tilla auditorit.
- Në rast se Joni i ka dhënë bankës një autoritet të përhershëm për të dhënë informacione të tilla tek auditorët, referojuni këtij autoriteti në letrën e bankës.
- Auditori e dërgon letrën direkt tek banka e Joni bashkë me një kërkesë që përgjigjet t'i dërgohen drejt për së drejti vetë auditorëve.

Detyra 2

AVAC Shpk monton pajisje elektronike siç janë televizorët, pajisje zërimi, kondicionet të ajrit, etj. Kompania zotëron katër fabrika të montimit në të cilat dërgohen pjesët dhe montohen pajisjet. Produktet montohen duke përdorur vija të kombinuara robotike dhe manuale të prodhimit. Punëtorët 'njerëzor' normalisht punojnë tetë orë standarde në ditë, edhe pse kjo plotësohet me punë jashtë orarit në baza të rregullta pasi që kompania është e stërmbushur me porosi. Është vetëm një turn në ditë; prodhimi masiv dhe puna me disa turne nuk është e mundur për shkak të natyrës së specializuar të pajisjeve që montohen.

Sistemi i pagave - punonjësit në turne

Punonjësit që punojnë në turne arrijnë në punë rreth orës 7.00 në mëngjes dhe hyjnë duke u regjistruar me kartelë elektronike të identifikimit. Kartela skanohet duke regjistruar orën dhe secili numër identifikues i punonjësve lexohet nga kartela e tyre përmes skanerit. Nga ky moment punonjësit konsiderohen si të regjistruar në këtë turn. Këta punonjës paguhen nga koha kur regjistrohen. Procesi i regjistrimit nuk monitorohet sepse supozon se punonjësit nuk do të punonin nëse nuk regjistrohen më parë në sitemin e regjistrimit të kohës.

Punonjësit e turnit janë të ndarë në grupe prej 25 punonjësish, dhe secili grup mbikqyret nga udhëheqësi i turnit.

Çdo ditë, secilit grup të punonjësve të turnit u jepet një produkt specifik për ta prodhuar. Së paku 400 produkte duhet të prodhohen secilën ditë nga secili grup i punës. Nëse është e domosdoshme punohet edhe jashtë orarit të punës për t'u arritur kuota e produkteve.

Nga udhëheqësi i turnit nuk kërkohet të monitoroj orët e punës jashtë orarit edhe pse udhëheqësi siguron se punonjësit nuk janë duke marrë pushime të zgjatura të cilat automatikisht do të rrisin kohën e punës jashtë orarit. Punonjësit e turnit ç'regjistrohen në fund të secilit turn duke e ri-skanuar kartelën e tyre identifikuese.

Pagesa e pagave

Detajet e orëve të punuara dërgohen në mënyrë elektronike në departamentin e pagave, ku orët e punës shpërndahen nga sistemi i kompjuterizuar i pagave tek të dhënat e secilit punonjës.

Personeli në departamentin e pagave i krahason orët e punuara nga sistemi i regjistrimit të kohës me sistemin e kompjuterizuar të pagave dhe e fut një kod për të konfirmuar saktësinë e transferit. Kodi poashtu shërben si autorizim për llogaritjen e pagës neto. Kodi është emri i qenit së udhëheqësit të departamentit të pagave prandaj ky kod dihet nga të gjithë në këtë departament. Çdo javë sistemi i kompjuterizuar i pagave llogaritë:

- i. pagat bruto, duke përdorur normën standarde dhe normat e punës jashtë orarit për orë për secilin punonjës,
- ii. zbritjet nga pagat që kërkohen me ligj (tatime, kontribute pensionale), dhe
- iii. pagën neto.

Lista e pagave neto për secilin punonjës pastaj dërgohet përmes rrjetit të brendshëm tek departamenti i kontabilitetit. Në departamentin e kontabilitetit, një nëpunës i kontabilitetit siguron se detajet e bankës së punonjësit janë në dosje. Pastaj nëpunësi i autorizon dhe i kryen pagesat për ata punonjës duke përdorur sistemin online bankar. Njëherë në disa javë, kontabilisti financiar e rishikon totalin e shumës së pagave të paguara për të siguruar se pasqyrat e menaxhmentit janë të sakta.

Largimi i punonjësve

Në disa raste, punonjësit largohen nga kompania. Kur ndodhë kjo, departamenti i personelit e dërgon një email në departamentin e pagave në të cilin paraqitet data e përfundimit të kontratës

dhe ditët e pashfrytëzuara të pushimit. Pranimi i emailit nga departamenti i pagave nuk monitorohet nga departamenti i personelit.

Sistemi i rrogave - menaxherët e turneve

Të gjithë menaxherët e turneve pagohen me rrogë vjetore; nuk ka pagesa të punës jashtë orarit. Rrogat janë rritur në korrik për 3% dhe është paguar një bonus vjetor prej 5% e rrogës në nëntor.

Kërkohet:

- a) Si auditor i jashtëm i AVAC Shpk, shkruani një letër të menaxhmentit për drejtorët sa i përket sistemit të regjistrimit të pagave dhe pagesës të punonjësve në turne e cila letër:
 - i. Identifikon dhe shpjegon PESË dobësi në atë sistem;
 - ii. Shpjegon efektin e mundshëm të secilës dobësi;
 - iii. Ofron rekomandime për të lehtësuar secilën dobësi. **(14 pikë)**

- b) Listoni TRE procedura analitike të cilat duhet të kryeni për sistemin e rrogave të menaxherëve të turnit. Për secilën procedurë, tregoni pritjet tuaja për rezultatet e asaj procedure. **(6 pikë)**

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja

Letra e menaxhmentit

Po ju shkruajmë të ju tërheqim vëmendje për çështjet në vijim:

Dobësia

Procesi i regjistrimit në turn i punonjësve nuk po monitorohet.

Puna jashtë orarit nuk autorizohet nga zyrtari përgjegjës

Kodi për autorizimin e sakësisë së kohës së punuar me sistemin e pagave është emri i macës së udhëheqësit të departamentit.

Shuma totale e pagave neto që i transferohet punonjësve nuk rakordohet me totalin e listës së pagave që prodhohet nga departamenti i rrogave.

Detajet e punonjësve që largohen nga kompania dërgohen me email nga departamenti i personelit në departamentin e rrogave.

Efekt i mundshëm

Punonjësit mund të sjellin kartela të punonjësve që mungojnë dhe t'i skanojnë për ata punonjës; punonjësit që mungojnë do të paguheshin për punën që nuk e kanë kryer.

Punonjësit mund të paguhen për punën që nuk e kanë kryer psh. ata mund të skanojnë kartelën me vonesë për të pranuar pagesën për overtime.

Kodi nuk është i sigurt dhe lehtë mund të hamendësohet nga punonjësit jashtë departamentit (emrat e kafshëve shtëpiake shpesh përdoren si fjalëkalim).

Punonjësit fiktiv – pagesa që mund të bëhen për persona që nuk janë punonjës të vërtetë – mund të shtohen në listën e pagesave tËp agave në departamentin e kontabilitetit.

Nuk ka kontroll për të siguruar se të gjitha emailat e dërguar janë pranuar aktualisht nga departamenti i rrogave.

Rekomandimi

Menaxheri i turnit mund të rakordon numrin e punëtorëve që janë prezent fizikisht në linjën e prodhimit me të dhënat e kompjuterizuara në numrit të punëtorëve që janë regjistruar për secilin turn.

Të gjitha pagesat e punës jashtë orarit duhet të autorizohen, ose nga menaxheri i turnit që do të autorizonte vlerën e parashikuar të kohës jashtë orarit para se turni të fillonte ose nga menaxheri që dot ë konfirmonte orët e regjistruara në sistemin e kompjuterizuar të departamentit e pagave pasi të përfundoj turni.

Kodi duhet të bazohet në sekuenca të rastësishme të shkronjave dhe numrave në bazë të rregullt.

Para se pagat neto të dërgohen në bankë për pagesë, kontabilisti financiar duhet të rapordoj totalin e listës së pagesës me totalin e pagave nga departamenti i pagave.

Duhet të ketë kontroll për të siguruar se të gjitha email-at janë pranuar nga departamenti – duke i paranumruar ato ose duke i shenjëzuar për të siguruar se pranimi kthehet tek departamenti i personelit.

Dobësia

Në departamentin e kontabilitetit, nëpunësi i autorizon pagesat e pagave neto të punonjësve.

Efekti i mundshëm

Nuk është e përshtatshme që personeli junior të nënshkruaj listën e pagave; nëpunësi nuk mund të identifikojë gabimet në listë të pagave ose edhe mund të shtoj 'punonjës fiktiv' dhe mund të autorizojë pagesën për këta 'persona'.

Rekomandimi

Lista e pagave duhet të autorizohet nga një menaxher senior ose drejtori financiar.

c) Procedurat analitike të pavarura**Procedura analitike**

Krahasoni totalin e kostos së rrogave të këtij viti me koston e rrogave të vitit të kaluar.

Vërtetoni sa menaxherë të turneve janë të punësuar nga ganta dhe totalin e rrogave nga departamenti i personelit.

Përftoni një listë të pagesave totale të rrogave për çdo muaj.

Pritjet

Duke supozuar se numri i menaxherëve të turnit ka mbetur i pandryshuar, totali i shpenzimit të rrogave do të duhej të ishte rritur vetëm sa është inflacioni.

Totali i rrogave dp të duhej të ishte përafërsisht numri i menaxherëve i shumëzuar me rrogën mesatare.

Totali i pagesave duhet të jetë përafërsisht i njëjtë nga korriku e tutje kur janë rritur rrogat dhe me nëntorin kur bonusi vjetor është paguar.

Detyra 3

Ju jeni asitent i auditorit në auditimin e kompanisë NESA Shpk. Auditori Senior ka kërkuar nga ju të planifikoni auditimin e pasurive jo-qarkulluese. Materialiteti i vlerësuar përkohësisht nga ai ishte 72,000 €.

NESA mban një regjistër të pasurive jo-qarkulluese. Kontabilisti i kompanisë harmonizon një mostër të regjistrimeve me pasuritë fizike dhe anasjelltas në baza tremujore. Për të gjitha blerjet kapitale kërkohet autorizimi. Artikujt që kanë vlerë më të vogël se 10,000€ mund të autorizohen nga menaxheri i prodhimit, ndërsa artikujt që kanë vlerë më të madhe se 10,000€ duhet të autorizohen nga drejtori menaxhues. Departamenti i blerjeve nuk do të porosit mallra kapitale nëse nuk janë të nënshkruara si duhet.

Kompani ka investuar një vlerë të madhe në një fabrik të re këtë vit që ka të bëjë me një projekt 8 vjeçar për një departament qeveritar.

Kontabilisti i NESA ju ka ofruar tabelën e mëposhtme për pasuritë jo-qarkulluese:

Kosto	Toka dhe ndërtesat	Fabrika dhe pajisjet	Kompjuterët	Automjetet	Gjithsej
31 dhjetor 2018	500,000*	75,034	30,207	54,723	659,964
Shtesat/blerjet		250,729	1,154		251,883
31 dhjetor 2019	500,000	325,763	31,361	54,723	911,847
Zhvlerësimi i akumuluar					
31 dhjetor 2018	128,000	45,354	21,893	25,937	221,184
Shpenzimet e vitit	8,000	28,340	2,367	13,081	51,788
31 dhjetor 2019	136,000	73,694	24,260	39,018	272,972
Vlera neto					
31 dhjetor 2018	364,000	252,069	7,101	15,705	638,875
31 dhjetor 2019	372,000	29,680	8,314	28,786	438,780

* Nga të cilat 100,000 EUR janë për tokën.

Kërkohet:

- Pa ndërmarrë ndonjë llogaritje, vlerësoni rrezikun e auditimit të pasurive jo-qarkulluese, duke ndarë në përbërës të rrezikut dhe duke arsyetuar konkluzionet tuaja. **(6 pikë)**
- Tregoni procedurat e auditimit të cilat do t'i ndërmerrnit ju për pasuritë jo-qarkulluese sa i përket pohimeve në vijim:
 - Ekzistenca **(3 pikë)**
 - Vlerësimi (duke përjashtuar zhvlerësimin) **(4 pikë)**
 - Plotësia **(3 pikë)**
- Përshkruani si do të vlerësonit përshtatshmërinë e normave të zhvlerësimit. **(4 pikë)**

[Total: 20 Pikë]

a) Vlerësimi i rrezikut të auditimit të pasurive jo-qarkulluese:

Rreziku i vetvetishëm

Pasuritë e preکشme jo-qarkulluese janë materiale, duke u bazuar në nivelin e propozuar të materialitetit. Ka pas një lëvizje substanciale në llogarinë e pajisjeve këtë vit, por kjo duket se mbështetet nga të dhënat e dhëna nga kontabilisti menaxherial. Duket se nuk ka pas shlyerje (shitje) gjatë vitit, gjë e cila mund të sugjeroj që janë anashkaluar ato, ose pajisjet e dëmtuara janë të përfshira në regjistër. Është gjithashtu e paqartë nëse toka është duke u zhvlerësuar. Do të ishte gabim nëse do të zhvlerësohej. Në përgjithësi, rreziku i vetvetishëm duket të jetë i mesëm.

Rreziku i kontrollit

Kontrollet mbi pasuritë afatgjata në NESA duket se janë të forta. Kompania mirëmban dhe harmonizon regjistrin e pasurive afatgjata dhe ka procedura autorizimi në aktivitet. Këto kontrolle duhet të testohen, dhe nëse dalin efektive, rreziku nga kontrollet mund të vlerësohet i ulët.

Rreziku i mos-zbulimit

Duke marrë se rreziku i vetvetishëm është përcaktuar si i mesëm dhe rreziku i kontrollit është përcaktuar si i ulët, rreziku i mos-zbulimit do të vlerësohet si më i lartë. Sidoqoftë, zakonisht ka dëshmi të mirë në lidhje me ekzistencën dhe vlerësimin e pasurive afatshkurta dhe këto janë pohimet kryesore për të cilat auditorët janë të interesuar.

Gjithashtu në punën e auditorëve janë të përfshira procedurat analitike, si psh prova në total e zhvlerësimit.

Përfundimi

Auditimi i pasurive jo-qarkulluese duket të jetë nga i mesëm në rrezik të ulët.

b) Procedurat e auditimit

(i) Ekzistenca

Në shumicën e rasteve është evidente se toka dhe ndërtesat ekzistojnë. Sidoqoftë, është me rëndësi që auditorët të verifikojnë të gjitha komponentet e tokës dhe ndërtesave të futura në bilanc të gjendjes, psh. nëse ato janë në vendndodhje të ndryshme nga ai ku janë të vendosur auditorët. Toka dhe ndërtesat duhet të verifikohen për dokumente pronësie për të treguar që jo vec që ekzistojnë por edhe janë në pronësi të klientit.

Kategoritë e tjera të pasurive duhet të inspektohen. Një mostër e asetëve nga regjistri duhet të rakordohet (harmonizohet) me pasuritë fizike. Mund të ketë plan për mbështetje në punën e kontabilistit menaxherial. Auditori duhet ta shikoj harmonizimin, të cilin e ka bërë kontabilisti. Auditorët duhet të inspektojnë gjendjen e pasurive për t'u siguruar që ato janë në përdorim. Veturat motorike duhet të harmonizohen sa i përket numrit të veturave që kanë ekzistuar në hapje dhe mbyllje. Prap, për t'u siguruar se ato jo vetëm që ekzistojnë, por edhe janë në pronësi të kompanisë, auditorët duhet t'i verifikojnë dokumentet e regjistrimit për t'u siguruar se kompania është pronare e regjistruar.

Për të gjitha pasuritë e mësipërme, auditori i jashtëm duhet gjithashtu të rishikojë provizionin e sigurimit të pasurive. Kjo jep dëshmi nga palët e treta mbi ekzistencën e pasurive derisa kompania e sigurimit nuk i siguron pasuritë që nuk ekzistojnë.

(ii) Vlerësimi (duke përjashtuar zhvlerësimin)

Toka dhe ndërtesat duket se janë të paraqitura me kosto historike derisa regjistri nuk i përmban fjalët "të vlerësuar". Auditori duhet të konfirmojë se njejtë është e trajtuar edhe nga kontabilisti menaxherial. Kosto mandej duhet të rakordohet me figurat e sjellura nga vitet e kaluara derisa nuk ka pasë blerje gjatë vitit. Këto figura janë audituara në vitet e kaluara. Nëse pasuritë mbahen në vlerësime, auditorët duhet të sigurojnë se kërkesas e SNK 16 në lidhje me rivlerësimet janë ndjekur dhe respektuar.

Ngjajshëm, derisa nuk ka pas lëvizje gjatë vitit, veturat motorike duhet të rakordohen (harmonizohen) në hapje.

Për të audituar vlerësimin e impijanteve dhe kompjuterave, auditorët duhet t'i rakordojnë balancat e hapjes. Ata duhet të marrin një regjistër të blerjeve të pasurive afatgjata, të cilat mund të rakordohen me faturat blerëse për të verifikuar vlerësimin.

Në fund, auditorët duhet të investigojnë se nëse kosto e figurave përfshinë ndonjë pasuri të fshirë plotësisht. Kjo nënkuptohet nga fakti se zhvlerësimi i impijanteve duke përjashtuar blerjet është i ulët. Nëse po, auditori duhet të kuptojë nëse këto asete janë ende në përdorim, dhe nëse jo, duhet të konsiderojë nëse ato duhet të përjashtohen nga figurat e kostos dhe zhvlerësimit të akumuluar që përfshihet në shënimet e llogarive. Përjashtimi i tyre do të kishte efekt net në shifrat e raportuara, do ta bënte shumën 0.

(iii) Plotësia

Regjistri i përgatitur i pasurive afatgjata duhet të harmonizohet me:

- Pozicionin e Hapjes (që është, bilanci i gjendjes i mëparshëm)
- Pozicionin e Mbylljes (Cka është shpalosur në pasqyra financiare)
- Regjistrimet e nënkuptuara (libri kryesor)

Nëse regjistri i pasurive afatgjata përmban detaje të kostos dhe zhvlerësimit të akumuluar të cdo pasurie, regjistri duhet të harmonizohet me skedulën. Për cdo diferencë duhet të mirren sqarimet. Blerjet në regjistër, gjithashtu duhet të verifikohen për t'u siguruar se pozicionet hapëse dhe mbyllëse rakordohen me regjistrin.

Auditorët duhet gjithashtu të bëjnë teste në disa prej blerjeve individuale, duke i ndjekur transaksionet në sistem, nga porositi e blerjeve në fletë dërgesa dhe fatura dhe përmes librave të pasqyrave financiare për t'u siguruar që blerjet janë përfshirë të plota.

c) Zhvlerësimi

(i) Përshtatshmëria

Përshtatshmëria e normave duhet të konsiderohet dhe të diskutohet me menagjmentin. Faktorët relevant për t'u konsideruar janë qështjet si:

- Politika për zëvendësim e pasurive
- Struktura e përdorimit në biznes.
- Qëllimi i pasurisë që është në pronësi

Në këtë rast, auditorët duhet të krijojnë arsyetimet për normat e përdorura të zhvlerësimit, në vecanti në rastin e impijanteve. Në rastin e impijanteve të blear këtë vit, norma e zhvlerësimit e aplikuar është 10%. Sidoqoftë, pasuritë janë blerë në lidhje me një projekt 8 vjeçar, prandaj 12.5% mund të jetë një normë më e përshtatshme.

(ii) Procedurat e auditimit

Zhvlerësimi në ndërtesa mund të verifikohet duke i harmonizuar datat e blerjeve të ndërtesave me dokumentet e blerjes / faturat e vitit të kaluar dhe vlerësimi i aplikuar në pjesën e ndërtesave. Për kategoritë tjera të pasurive, zhvlerësimi duhet të harmonizohet për pasuritë individuale, pasi që nuk është e mundur të rakordohen ato në total. Auditorët duhet të marrin zberthim të zhvlerësimit për vitin aktual. Ata duhet të kenë mundësi për ta rikalkuluar zhvlerësimin nga detajet e regjistrit të pasurive afatgjata dhe t'i krahasojnë rezultatet.

Detyra 4

(a) Konsideroni situatat që janë paraqitur gjatë punës së auditimit në tri kompani të ndryshme. Secila situatë është materiale.

Kërkohet:

Diskutoni çfarë hapa shtesë duhet të merr Auditori në secilin rast të veçantë bazuar në informatat e dhëna në pyetjet e mëposhtme duke përfshirë edhe llojin e opinionit të auditorit që ju mendoni ta jepni si rezultat i tri situatave më poshtë.

(i) Jeni duke e finalizuar auditimin e Lipa ShA dhe e keni vërejtur se në raportin vjetor (që i bashkangjitet pasqyrave financiare) nga drejtori, fitimi neto është paraqitur në vlerë prej €1,000,000, krahasuar me €500,000 në paqyrën e të ardhurave. Nga diskutimi me menaxhmentin, ju keni zbuluar se ndryshimi është rezultat i mospajtimit nga menaxhmenti të korrigoj provizionet për borxhet e dyshimta. Ju besoni se shifra në pasqyrën e të ardhurave është paraqitur drejtë. **(4 pikë)**

(ii) Jeni duke e finalizuar auditimin e Ora ShA dhe keni vërejtur se kompania është në mosmarrëveshje me bankën, e cila kishte kërkuar kthimin e plotë të kredisë brenda gjashtë muajve të ardhshëm. Ora ShA nuk do të ketë mundësi të përmbushë këtë obligim pa përfituar ndonjë financim tjetër. Edhe pse negociatat me një institucion tjetër financiar për rifinancim janë duke ecur mirë, ende nuk është arritur ndonjë marrëveshje për kredi. Kjo pasiguri lidhur me kredinë është shpalosur në mënyrë të mjaftueshme në pasqyrat financiare të kompanisë. **(7 pikë)**

(iii) Si pjesë e auditimit të Tayna ShA, ju keni marrë pjesë në numërimin e stoqeve. Gjatë rishikimit të stoqeve ju keni kuptuar se Tayna ShA ka një sasi domethënëse të stoqeve të fustaneve me ngjyrë portokalli me xixa. Ju besoni se e gjithë sasia e këtyre stoqeve duhet të shlyhet nga librat. Në rishikimin pasues të këtyre stoqeve keni kuptuar se fustanet me ngjyrë portokalli me xixa, herën e fundit janë shitur para dy vitesh. Vlera totale e këtyre stoqeve është €200,000 (15% e stoqeve totale në pasqyrën e pozicionit financiar). Në diskutimet me menaxhmentin ata ju kanë bërë të qartë se nuk do të korrigojnë pasqyrat financiare pasi që besojnë se këto fustane do të kthehen në modë së shpejti. **(4 pikë)**

(b) Shpjegoni se çka nënkupton raporti i pamodifikuar i auditimit dhe kur mund të jepet ky raport. **(5 pikë)**

[Total: 20 pikë]

Zgjidhja

(a)

i. Ky është shembull kur 'informatat tjera' nuk janë konsistente me informatat në pasqyrat financiare. Ju keni përcaktuar se shifra në pasqyra financiare është e saktë ndërsa në raportin e menaxhmentit e pasaktë. Duhet të diskutohet me menaxhmentin për mundësinë e ndryshimit të raportit të drejtorit. Nëse menaxhmenti refuzon të korrigjojë, auditori duhet të përfshijë një paragraf shpjegues në të cilin përshkruhet jokonsistenca materiale në mes të informatave në pasqyra financiare dhe në raportin e drejtorit.

ii. Çështja e dytë ka të bëjë me pasiguri materiale. Kjo çështje ka ndikim në hipotezën e vijimësisë së kompanisë prandaj duhet të përfshihet një paragraf i theksimit të çështjes, edhe pse raporti i auditimit nuk do të rezervohej. Nga ju pritet të rishikoni shënimin shpjegues të pasqyrave financiare si dhe të identifikoni se deri ku kanë arritur diskutimet me bankën para se ju të nënshkruani raportin e auditimit.

iii. Ky është shembull i mosmarrëveshjes me menaxhmentin. Përveç nëse menaxhmenti mund të ju ofrojë dëshmi për të mbështetur deklaratimet e tyre se fustanet do të shiten, ju duhet të rezervoni opinionin. Ky është rast i mosmarrëveshjes i cili rezulton me 'përveç për' opinion pasi që shuma është materiale mirëpo jo përhapësë.

(b) Çka nënkuptohet nga raporti pazezervë

a. Janë mbajtur regjistrat e duhur kontabël

b. Pasqyrat financiare pëputhen me regjistrat dhe librat

c. Të gjitha informacionet dhe shpjegimet janë pranuar nga auditori

d. Auditori ka pasur qasje të pakufizuar në libra dhe regjistra të kompanisë

e. Janë shpalosur të gjitha informatat që është dashur të shpalosen si kërkesë e legjislacionit dhe standardeve të raportimit

Përveç kësaj, sipas SNA 700, në mënyrë që auditori të jep një opinion të pamodifikuar duhet

- Përftojë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit nëse pëasqyrat financiare nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimeve;
- Sigurohet se nuk ka anomali të pakorrigjuara të cilat mund të jenë materiale, individualisht ose të grumbulluara. Ky vlerësim duhet të përfshijë konsiderimin e aspekteve cilësore të praktikave të kontabilitetit të entitetit, përfshirë anshmërinë nga menaxhmenti.
- Sa i përket paraqitjes së drejt dhe të sinqertë, auditori duhet të sigurohet se janë përfshirë të gjitha shënimet shpjeguese në pasqyra financiare; dhe
- Pasqyrat janë përgatitur në pajtueshmëri me standardet e zbatueshme të kontabilitetit në juridiksionin përfshirë çfardo kërkesë ligjore.

Detyra 5

Ju jeni keni pozitën e menaxherit të auditimit në firmën e auditimit Gema. Njëri nga klientët tuaj, Gurët e Artë (GA), blen stoli nga diamantet nga tre prodhues të ndryshëm. Pastaj këto stoli shiten nga katër dyqanet e kompanisë. Ky është klienti i vetëm i firmës tuaj që është në industrinë e diamanteve. Ju jeni duke planifikuar të merrni pjesë në numërimin e stoqeve të GA. Stoqet janë llogaria më e madhe në pasqyrën e pozitës financiare dhe secila prej katër dyqaneve të kompanisë mban stoqe materiale të diamanteve. Për shkak të vlerës së lartë të stoqeve, të gjitha dyqanet do të vizitohen nga auditorët dhe do të numërohen stoqet. Me miratimin e drejtorëve të GA, ju keni punësuar firmën LEMO, e specializuar në vlerësimin e diamanteve të cilët gjithashtu do të jenë të pranishëm gjatë numërimit. LEMO do të verifikojnë nëse stolitë janë të punuara nga diamantet si dhe nëse mund të shiten duke konsideruar trendet e modës për këto stoli. LEMO gjithashtu do të sugjeroj, në bazë të mostrës, vlerën e njësisë specifike të stolisë. Numërimi do të bëhet nga personeli i dyqanit (në ekip nga dy persona) duke përdorur lista të paranumëruara.

Kërkohe:

- a) (a) Tregoni procedurat kyçe të auditimit që duhet të kryhen lidhur me numërimin e stoqeve që mbahen nga dyqanet dhe shpjegoni qëllimin e secilës procedurë. **(10 pikë)**
- b) (b) Vlerësoni faktorët që duhet të konsiderohen para se të vendoset nëse mund të mbështetemi në punën e vlerësuesve nga JOMO. **(5 pikë)**
- c) (c) Rekomandoni procedurat e auditimit që duhet të kryhen për të siguruar se stoqet e stolive janë vlerësuar si duhet. **(5 pikë)**

[Total: 20 Pikë]

Zgjidhja

(a)

Procedura e auditimit

Kryeni një rishikim të përgjithshëm të udhëzimeve për numërimin e stoqeve për tu siguruar se:

Stoqet janë ndarë në seksione të duhura – psh sipas llojit të stolisë

Personeli është duke numëruar në çift, njëri person numëron tjetri i regjistron detajet.

Ka kontrolle të duhura për të siguruar se secila njësi e stokut numërohet një herë. Dyqani është i mbyllur gjatë numërimit

Listat e numërimit janë të paranimëruara

Merrni një mostër të artikujve të stoqeve që tashmë është regjistruar në listë dhe përputhenim me stokun e stolive

Merr një mostër të stolive dhe përputhi me listat e numërimit

Merr një mostër të listës së numërimit, fotokopjo dhe vendose në dosjen e auditimit. Kontrolloni nëse të gjitha listat e numërimit janë kthyer në kompani pas kryerjes së numërimit. Merrni numrin e fundit të fletpranimit dhe faturës së shitjes

Rishikoni kushtet e stolive me vlerësuesin e pavarur. Sigurohuni se nuk ka arsye që stoku të jetë i dal nga moda ose i dëmtuar.

Formoni një opinion lidhur me saktësinë e përgjithshme të numërimit të stoqeve.

Arsyet për kryerjen e procedurës

Kontrolloni nëse udhëzimet e klinetit për numërimin e stoqeve janë duke u ndjekur nga personeli që do të siguroj se numërimi është i plotë dhe i saktë.

Konfirmoni rradhitjen e stoqeve për të siguruar se nuk është anashkaluar asnjë artikull.

Parandaloni marrëveshjen e fshehtë dhe ofron siguri për stoqet (stolitë kanë vlerë të lartë) dhe se listat e stoqeve nuk janë falsifikuar. Kontrolloni për të siguruar se stoqet nuk janë numëruar dy herë

Për të siguruar se nuk ka hutitje për stoqet që janë shitur gjatë numërimit

Për të siguruar se nuk ka lista të humbura të numërimit

Për të siguruar se stoqet e regjistruara në lista me të vërtetë ekzistojnë

Për të siguruar se të gjitha stoqet janë regjistruar – plotësia e regjistrimit

Për të kontrolluar se detajet në listat e numërimit nuk janë ndryshuar pas numërimit. Për të siguruar se të gjitha listat janë plotë prandaj nuk ka nënvlerësim

Për të siguruar se prerja është e saktë. Kontrolli pasues duhet të paraqes se të gjitha mallrat e pranuar pas numërimit të stoqeve nuk janë përfshirë në llogaritë e pagueshme dhe faturat e shitjes pas numërimit të stoqeve nuk janë përfshirë në shitjet e këtij viti.

Për të kontrolluar nëse ka stoqe të vjetëruara ose të dëmtuara - vlerësimi

Për të konfirmuar se saktësi e stoqeve janë regjistruar saktë

(b) Faktorët që duhet konsideruar nëse mund të mbështetemi në punën e ekspertit

Auditori duhet të konfirmojë nëse ka nevojë për ekspert. Nuk është e qartë nëse auditori ka ekspertizën e duhur, mirëpo pasi që GA është klienti i vetëm në këtë industri, do të ishte e qartë se auditori i nvojitet ndihmë pasi që vlerësimi i diamantëve është i vështirë.

Kontrolloni nëse eksperti (specialisti) ka përvojën relevante në vlerësimin e stolive të diamanteve. Si pjesë e procesit të angazhimit të ekspertit duhet të jetë edhe rishikimi i portfolit të kompanisë së vlerësimit dhe punës së mëparshme në vlerësimin e diamantëve.

Specialisti duhet të jetë anëtarë i një organizate profesionale për këtë çështje. Kjo i ndihmon auditorit të sigurohet se specialisti ndjek standarde të përshtatshme të etikës.

Kontrollo nëse kompania e vlerësimit mund të ndikohet nga klienti ynë (psh janë të punësuar të GA). Në rastet e tilla specialist nuk do të ishte i pavarur dhe kështu raporti i tij nuk do të kishte vlerën e duhur.

Kontrollo nëse raporti i prodhuar ngaspecialisti lidhur me vlerësimin duket të jetë i arsyeshëm. Edhe pse auditori nuk ka klient tjerë në industrinë e diamantëve, auditori mund të bëjë krahasim të thjeshtë të çmimit dhe peshës së diamantit e cila mund të merret nga interneti ose dyqanet tjera për tu siguruar në saktësinë e shifrave të GA.

(c) Dëshmitë e auditimit

Për tu siguruar se stoqet e stolive vlerësohen saktë, auditori duhet të kryej procedurat në vijim: Stoqet duhet të vlerësohen sipas koston ose vlerës neto të realizueshme.

- Për një mostër të stolive në listën e stoqeve, ndjek koston e tyre deri te fatura origjinale e blerjes, duke u siguruar se përshkrimi i mallit në faturë përputhet me stolitë.
- Për stolitë e shitura pas fundit të vitit, krahaso një mostër të faturave të shitjes me listën e stoqeve dhe sigurohu se çmimi i shitjes është më i lart se kosto. Në rastet kur vlera e shitjeve është më e ulët se kosto, sigurohu se stolitë janë paraqitur me vlerën e tyre të realizueshme në listën e stoqeve.
- Rishiko raportin e vlerësuesit profesionist. Sigurohu se stoqet janë të vërteta. Për zërat e kontrolluar nga vlerësuesi, përputhni vlerësimin e atij artikulli me listën e stoqeve. Nëse ka diferenca, psh për shkak të vjetërsisë së stoqeve ose për shkak të daljes nga moda, diskuto me klientin dhe pajtohuni për vlerën reale të atyre artikujve. Në këtë rast vlera e artikujve duhet të japet nga vlerësuesi profesionist

Në rastet kur një artikull ka qenë në stoqe për një periudhë më të gjatë kohore, (psh më shumë se një vit), kontrollo raportin e vlerësuesit nëse kërkohet provizionim i duhur.